Alpage
environmental & social
performance · compliance · governance



Shqipëri – FV Lundrues KESH

Përmbledhje jo teknike

Data: 04.10.2020

Versioni: B

Referenca: 20g09B

Përgatitur për: BERZH

Projekt i zhvilluar nga: KESH

1 Përshkrim i projektit

1.1 Konteksti

Në përputhje me objektivat e përcaktuara nga Qeveria Shqiptare në Strategjinë Kombëtare të Energjisë 2017-2030 dhe Planin Kombëtar të Konsoliduar të Veprimit për Burimet e Rinovueshme të Energjisë 2019-2020 KESH sh.a. (KESH) po kërkon të rrisë dhe diversifikojë prodhimin dhe tregtimin e energjisë nga burimet e tij të rinovueshme, me qëllim rritjen e përfitimit ekonomik dhe konkurrencën në tregun e brendshëm ose rajonal.

Në 2018 KESH përgatiti një studim para-fizibiliteti mbi termat teknikë dhe ekonomikë, për instalimin e një impianti fotovoltaik (FV) lundrues në sipërfaqen e rezervuarit të Vaut të Dejës, diga dhe hidrocentrali i të cilit administrohen gjithashtu nga KESH. Objektivi i Projektit është instalimi dhe veprimi/funksionimi i këtij impianti fotovoltaik lundrues.

1.2 Karakteristikat kryesore

Projekti do të zhvillohet në rezervuarin e Vaut të Dejës, në Veri të Shqipërisë, pranë qytetit të Vaut të Dejës (Figura 1). Sipërfaqja e FV lundrues do të jetë rreth 12 ha (e barabartë me një katror 350 x 350 m). Krahasuar me sipërfaqen e përgjithshme të rezervuarit, kjo përfaqëson 0.45% të sipërfaqes së rezervuarit.

Kapaciteti i instaluar i parashikuar është 12,9 MW fuqi maksimale: prodhimi mesatar vjetor i energjisë do të jetë 17434 MWh: kjo korrespondon me konsumin mesatar të një qyteti me 10 000 banorë.

FV lundrues do të ankorohet në fundin e rezervuarit (me blloqe betoni, vida toke/augers ose pajisje të ngjashme), lidhur me FV lundrues me kabllo nënujorë. Impianti FV do të përfitojë nga afërsia me hidrocentralin e Vaut të Dejës, dhe do të ketë kësisoj një lidhje të afërt me rrjetin. Nuk do të ketë nevojë për linja transmisioni të gjata ose linja të tensionit të lartë.

Disa vendndodhje u vlerësuan për FV lundrues (figura 1). Gjiri i Gomsiqes u përjashtua për arsye të përbashkëta të konservimit të larmisë biologjike dhe ruajtjes së turizmit/pejzazhit.

Figura 1 – Opsionet e vendndodhjes së FV lundrues

Figura 1 –Vendndodhja e projektit: pamje e përgjithshme



1.3 Dizaini, ndërtimi dhe operimi

Projekti është planifikuar të hartohet dhe ndërtohet përmes një kontrate të vetme Inxhinieri Prokurim Ndërtim (IPN) me KESH.

Ndërtimi do të zgjasë 6 deri në 8 muaj. Rruga kryesore e furnizmit të Projektit pritet nga porti i Durrësit, që gjendet 100 km larg zonës së Projektit. Numri i stafit të punësuar do të jetë më pak se një qind persona në kulmin e punimeve; mesatarisht, disa dhjetëra punonjës të stafit do të punësohen gjatë ndërtimit.

Zona e kalatës ekzistuese (Figura 3), pranë digës së Qyrsaqit do të përdoret për ndërtim:

Figura 3 – Pamje e kalatës ekzistuese pranë digës së Qyrsaqit

Figura 4 – Aspekte pamore tw njw FV lundruese (Piolenc, Francw)

Panelet fotovoltaike humbasin rendimentin e tyre përgjatë viteve. Jetëgjatësia e përdorimit të FV lundrues vlerësohet të jetë deri në 20 vjet, pas të cilëve rendimenti i paneleve diellore pritet të jetë më pak se 80%.

2 Kuadri i përputhshmërisë

2.1 Legjislacioni shqiptar

Projekti do të zhvillohet dhe do të operojë në përputhje me legjislacionin shqiptar. Një Vlerësim i Ndikimit në Mjedis Paraprak është kryer dhe do të pasohet nga një Vlerësim i Ndikimit në Mjedis i Detajuar.

2.2 Politika Mjedisore dhe Sociale e BERZH

Projekti është duke u zbatuar edhe në përputhshmëri me Politiken Mjedisore dhe Sociale të BERZH. Nje vlerësim mjedisor dhe social u krye dhe tregon se:

- Projekti nuk ka ndikim të perceptueshëm në habitatet kritike ose në objektivat konservues të zonave të mbrojtura apo të njohura ndërkombëtarisht.
- Projekti nuk kërkon zhvendosje ose ndonjë formë tjetër të qënësishme dhe afatgjatë të ndikimit social.
- Projekti nuk është pjesë e listës së Aneksit IIa të Direktivës për VNM të EU që kërkon një VNM të detajuar.

Projekti bën pjesë në kategorinë B sipas Politikës Mjedisore dhe Sociale të BERZH.

3 Masat zbutëse të rrezikut mjedisor dhe social

3.1 Masat zbutëse të rrezikut mjedisor

Vlerësimi mjedisor bazë i ndërmarrë për rezervuarin e Vaut të Dejës tregon se:

- Rezervuari ka ngarkesë të qënësishe të ushqyesve, dhe shtresat me të thella kanë mungesë oksigjeni.
- Pjesët më të cekta të rezervuarit, vecanërisht brigjet dhe Gjiri I Gomsiqes, janë ato më të pasurat me biodiversitet.
- Rezervuari strehon shtatë specie me interes për ruajtje: tre molluskë, dy karavidhe dhe dy specie të peshkut.
- Zona e rezervuarit ku është parashikuar FV lundrues, është përgjithësisht jashtë zonave të mbrojtura apo të njohura ndërkombëtarisht, me përjashtim të fundit lindor të Zonës Kyce të Biodiversitetit "Liqeni i Shkodrës – Lumi Buna – Velipoja - Vau i Dejës". "Mjet për Vlerësimin e Integruar të Biodiversitetit”

Masat kryesore zbutëse të Projektit për ruajtjen e larmisë biologjike përfshijnë (i) shmangien e Gjirit të Gomsiqes, (ii) mbledhjen dhe zhvendosjen e specieve pak të lëvizshme me interes për ruajtje (moluskë dhe karavidhe) nga zona e montimit të FV lundrues, (iii) shmangien e fillimit të ndërtimit në periudhën e lëshimit të vezëve të peshqëve, (iv) shmangien e ndriçimit të përhershëm të FV lundrues, (v) masa parandaluese kundër zjarrit, (vi) zhvillimin e njohurive shkencore dhe monitorimin afat-gjatë të specieve me interes për ruajtje, me synim përfshirjen e tyre në listën e kuqe kombëtare dhe përditësimin e informacionit mbi to në faqen elektronike të Unionit Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës.

3.2 Rreziqet sociale dhe masat zbutëse

Projekti nuk kërkon asnjë formë zhvendosjeje. Megjithatë, zona e Projektit është me interes për aktivitetet e turizmit dhe të shodhjes. Peizazhi I Gjirit të Gomsiqes është i bukur dhe burim për aktivitete turizmi (lundrim, kafe dhe restorante) dhe duhet të ruhet.

Sipërfaqja e përzgjedhur për montimin dhe vendosjen FV lundrues ka më pak vlera pamore dhe tëpeizazhit. Megjithatë, ajo përdoret për të mbërritur në rezervuar (nje kalate betony ekzistuese për varkat). Kjo sipërfaqe është planifikuar të jetë pjesë e zhvillimit të Bashkisë të Vau të Dejës: Plani Bashkiak për Zhvillimin e Territorit, i aprovuar në 2018 nga Këshilli Kombëtar i Territorit, si autoriteti më i lartë planifikues në Shqipëri, parashikon nisa të ndryshme sociale dhe ekonomike për tu zhvilluar në rezervuar. Plani e konsideron rezervuarin si një korridor për të ndërtuar një itinerar të integruar turistik nga Alpet e Shqipërisë drejt Detit Adriatik, i cili do kërkojë ndërtimin e një pontili të anijeve turistike afër FV lundrues.

Masat kryesore zbutëse për rreziqet e mundshme sociale dhe ndikimin e Projektit përfshihjnë (i) shmangien e Gjirit të Gomsiqes, (ii) ruajtjen e përdorimeve ezistuese të rezervuarit dhe aksesin në to përgjatë ndërtimit dhe operimit, (iii) bashkërendim dhe marreveshje formale me Bashkinë e Vaut të Dejës në lidhje më planin e vendosjes se FV lundrues, në mënyrë që të sigurohet përputhshmëria më Planin e Zhvillimit të Territorit, (iv) shmangien e shqetësimit gjatë ndërtimit, (v) ndërtimin, për arsye të sigurisë publike, të një gardhi pluskues përreth FV lundrues, (vi) zbatimin e planit të përfshirjes së palëve të interesuara, përfshirë mekanizmat e ankimimit.

4 Kontakt

Nesë ju jeni të interesuar pwr Projektin dhe dëshironi të merrni më shumë informacion, ju lutem kontaktoni KESH duke përdorur detajet e mëposhtme të kontaktit:

Emri dhe pozicioni	Për tu plotësuar nga KESH
E-maili	Për tu plotësuar nga KESH
Telefoni	Për tu plotësuar nga KESH